



Në bazë të nenit 35, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, dhe nenit 65, paragrafët 1 dhe 2, të Ligjit Nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 77/16 Gusht 2010), të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 05/L-150 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 10/03 Prill 2017), si dhe nenin 8 dhe nenin 109, paragrafi 4, të Ligjit Nr. 08/L-304 për Bankat (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 2/27 janar 2026), Bordi i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës në mbledhjen e mbajtur më 29 qershor 2026 miratoi këtë:

RREGULLORE PËR INSTRUMENTIN E INSTITUCIONIT URË

Neni 1

Qëllimi dhe fushëveprimi

1. Kjo rregullore përcakton kushtet me qëllim zbatimin e instrumentit të institucionit urë, licencimin dhe operacionet e institucionit urë, në zbatim të procesit të përmbylljes së bankave.
2. Kjo rregullore zbatohet për të gjitha bankat në Republikën e Kosovës, të licencuara nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, me përjashtim të degëve të bankave të huaja.

Neni 2

Përkufizimet

1. Të gjitha shprehjet e përdorura në këtë rregullore kanë kuptimin e njëjtë siç përcaktohen në nenin 3 të Ligjit Nr. 08/L-304 për Bankat, dhe/ose siç përcaktohet këtu për qëllimin e kësaj rregulloreje:
 - 1.1. **Ligji për Bankat** - Ligji Nr. 08/L-304 për Bankat;
 - 1.2. **Institucion Urë**- nënkupton një person juridik që i plotëson kërkesat e përcaktuara në paragrafin 3. të nenit 109 të Ligji për Bankat;
 - 1.3. **Instrumenti i institucionit urë** – nënkupton mekanizmin për transferimin e aksioneve ose instrumenteve tjera të pronësisë të emetuara nga një bankë në kuadër të procesit të përmbylljes; ose pasurive, të drejtave ose detyrimeve të një banke në kuadër të procesit të përmbylljes tek një institucion urë, në pajtueshmëri me nenin 109 të Ligjit për Bankat;
 - 1.4. **BQK si autoritet mbikëqyrës**- nënkupton BQK-në si autoritet mbikëqyrës ose licencues;
 - 1.5. **Instrumentet e përmbylljes**- nënkupton instrumente të përmbylljes të përcaktuara në nenin 107 të Ligjit për Bankat;
2. Përveç rasteve kur specifikohet ndryshe, referencat për BQK-në në këtë rregullore, interpretohen për BQK-në në cilësinë e autoritetit të përmbylljes.

Neni 3

Kushtet bazike për zbatimin e instrumentit të institucionit urë

1. BQK mund të zbatojë instrumentin e institucionit urë, në mënyrë individuale ose në kombinim me instrumentet tjera të përmbylljes, për bankat që përmbushin kushtet e zbatueshme për përmbyllje në pajtim me nenin 106 të Ligjit për Bankat.
2. Për të zbatuar instrumentin e institucionit urë dhe duke marrë parasysh nevojën për të mbajtur funksionet kritike në institucionin urë, BQK ka kompetencë të transferoj në një institucion urë:
 - 2.1 aksione ose instrumente të tjera të pronësisë të emetuara nga një bankë ose më shumë banka në proces të përmbylljes;
 - 2.2 të gjitha asetet ose një pjesë të aseteve, të drejtat ose detyrimet e një ose më shumë bankave në proces të përmbylljes.
3. Transferimi i aksioneve ose instrumenteve të tjera të pronësisë të emetuara nga një ose më shumë banka në proces të përmbylljes dhe/ose i aseteve, të drejtave ose detyrimeve të një ose më shumë banke në proces të përmbylljes, në tërësi ose pjesërisht, kryhet drejt një institucioni urë, në pajtim me vendimin e BQK-së, me qëllim arritjen e objektivave të përmbylljes të përcaktuara në nenin 100 të Ligjit për Bankat.
4. Në rastet kur vendimi i BQK-së për fillimin e procedurave të përmbylljes përcakton se përmbyllja do të realizohet përmes instrumentit të institucionit urë, nëpërmjet transferimit të aksioneve ose instrumenteve të tjera të pronësisë të emetuara nga një ose më shumë banka në proces të përmbylljes, BQK merr vendim për themelimin e institucionit urë përmes transferimit të instrumenteve të pronësisë të bankës në proces të përmbylljes.
5. Në rastet kur vendimi i BQK-së për fillimin e procedurave të përmbylljes përcakton se përmbyllja do të realizohet përmes transferimit, në tërësi ose pjesërisht, të aseteve, të drejtave ose detyrimeve të bankës në proces të përmbylljes drejt institucionit urë, BQK merr vendim për ndarjen e bankës në proces të përmbylljes në pajtim me nenin 110 të Ligjit për banka duke themeluar një institucion urë me asetet, të drejtat dhe detyrimet e bankës në proces të përmbylljes dhe autorizon realizimin e transferimit drejt institucionit urë të themeluar për këtë qëllim.
6. Institucioni urë, sipas këtij neni duhet të jetë person juridik i themeluar dhe i organizuar si shoqëri aksionare dhe duhet të jetë tërësisht apo pjesërisht në pronësi nga një ose më shumë autoritete publike, të cilat mund të përfshijnë BQK-në, si dhe kontrollohet nga BQK.
7. Në vendimin për themelimin e institucionit urë, BQK si autoritet mbikëqyrës, në pajtueshmëri me objektivat për përmbyllje të parapara në nenin 100 të Ligjit për banka dhe duke pasur parasysh kushtet për përmbyllje të përcaktuara në nenin 106 të Ligjit për Bankat, mund të vendosë kërkesa më të lehta për licencimin dhe mbikëqyrjen e institucionit urë, në krahasim me kërkesat e përcaktuara për bankat e tjera të licencuara nga BQK si autoritet mbikëqyrës, gjatë fillimit të ushtrimit të veprimtarisë së institucionit urë, duke përcaktuar periudhën e përkohshme gjatë së cilës do të zbatohen këto kërkesa.
8. Kërkesat më të lehta sipas paragrafit 7 të këtij neni, mund të përfshijnë kërkesa më të lehta për kapitalin minimal të paguar, dokumentacionin për miratimin e Drejtorëve dhe Menaxherëve të lartë, si dhe lidhur me zbatimin e treguesve mbikëqyrës të parashikuar me Ligjin për Bankat dhe rregullativen përkatëse të BQK-së.
9. BQK komunikon me Qeverinë e Republikës së Kosovës, për të vlerësuar përdorimin e mundshëm të fondeve publike për qëllime të financimit të kapitalit të institucionit urë, përfshirë dhënien e

kredisë për Fondin e Përmbylljes dhe në pajtim me instrumentet qeveritare të qëndrueshmërisë financiare të përcaktuara në nenin 123 të Ligjit për Bankat si dhe rregullat për mbështetjen financiare publike kur është e aplikueshme.

10. BQK sa më shpejte që është e mundur, i dorëzon vendimet e përmendura në paragrafët 3 dhe 4 të këtij neni bankës në proces të përmbylljes dhe Agjencisë për Regjistrimin e Bizneseve (ARBK) si dhe personave ndaj të cilëve vendimi ka efekt, për pjesën që vendimet kanë të bëjnë me ta.
11. Për transferimet e përmendura në paragrafin 2 të këtij neni nuk kërkohet pëlqimi i aksionarëve të bankës në proces të përmbylljes ose i personave të tjerë, as respektimi apo veprimi sipas kërkesave të procedurave të parashikuara në legjislacionin relevant për shoqëritë tregtare apo të letrave me vlerë.
12. Vendimet e BQK-së sipas kësaj rregullore mund të kundërshtohen në mënyrën e përcaktuar në nenin 145 të Ligjit për Bankat.
13. Në pajtim me paragrafin 8 të nenit 102 të Ligjit për Bankat, BQK dhe Fondi Kombëtar i Përmbylljes mund të rimarrin çdo shpenzim të arsyeshëm të shkaktuar me përdorimin e instrumenteve dhe kompetencave të përmbylljes ose të instrumenteve të qeverisë për stabilizim financiar në një ose disa nga mënyrat e mëposhtme:
 - 13.1. si shumë e zbritshme nga çdo vlerë e paguar nga një pranues i bankës në proces të përmbylljes ose, sipas rastit, për pronarët e aksioneve ose instrumenteve të tjera të pronësisë;
 - 13.2. nga banka në proces të përmbylljes, si një kreditor i preferuar; ose
 - 13.3. nga çdo e hyrë e gjeneruar si rezultat i ndërprerjes së funksionimit të institucionit urë ose subjektit për menaxhimin e aseteve, si një kreditor i preferuar.
14. Objektivat e institucionit urë nuk nënkuptojnë asnjë detyrë apo përgjegjësi ndaj aksionarëve apo kreditorëve të bankës në proces të përmbylljes, dhe organi drejtues apo menaxhmenti i lartë nuk do të kenë përgjegjësi ndaj këtyre aksionarëve apo kreditorëve për veprimet apo mosveprimet gjatë ushtrimit të detyrave të tyre, përveç nëse veprimi apo mosveprimi përbën neglizhencë të rëndë ose sjellje të rëndë të pahijshme, në përputhje me legjislacionin kombëtar, që ndikon drejtpërdrejt në të drejtat e këtyre aksionarëve apo kreditorëve.
15. Kur BQK vendosë të zbatoj një instrument të përmbylljes ndaj një banke, dhe ai veprim i përmbylljes do të rezultonte me bartjen e humbjeve nga kreditorët ose me konvertimin e kërkesave të tyre, BQK do të ushtrojë kompetencën për zvogëlimin e vlerës dhe konvertimin e instrumenteve të kapitalit në përputhje me nenin 112 të Ligjit për Bankat, menjëherë para ose njëkohësisht me aplikimin e instrumentit të përmbylljes. Kompetenca për zvogëlim të vlerës ose konvertim në lidhje me detyrimet e një banke në përmbyllje, në përputhje me nenin 111 të Ligjit për Bankat, mund të aplikohet gjithashtu në kombinim me instrumentin e institucionit urë.
16. Çdo transferim sipas kësaj Rregullore është subjekt i vlerësimit të përcaktuar në nenin 102 të Ligjit për Bankat dhe në rregulloren përkatëse të BQK-së për qëllime të përmbylljes. Para marrjes së vendimit për transferimin e aksioneve, aseteve, të drejtave ose detyrimeve në një institucion urë, BQK do të sigurojë që vlerësimi të jetë i drejtë, i kujdesshëm dhe realist. Kur, për shkak të urgjencës, një vlerësim i pavarur nuk është i mundur brenda afatit të kërkuar, BQK mund të mbështetet në një vlerësim të përkohshëm në përputhje me Ligjin për Bankat. Çdo vlerësim i përkohshëm duhet të përfshijë një rezervë për humbjet shtesë në shumën e panjohur ose për një periudhë kohore të pasigurt dhe është subjekt i çdo vlerësimi pasues të kërkuar sipas Ligjit për Bankat.

Neni 4

Licencimi institucionit urë

1. Kërkesa për licencimin e institucionit urë duhet të paraqitet nga aksionaret e propozuar të saj dhe duhet të shoqërohet me dokumentacion sikurse kërkohet me Ligjin për Banka dhe rregullativen përkatëse të BQK-së, të aplikueshme për licencimin e bankave.
2. Pavarësisht dispozitës së paragrafit 1 të këtij neni, kur është e nevojshme për të përmbushur objektivat e përmbylljes të përcaktuara me nenin 100 të Ligjit për Banka dhe duke konsideruar kushtet për përmbyllje të përcaktuara në Nenin 106 të Ligjit për Bankat, institucioni urë mund të themelohet dhe licencohet në pajtim me kërkesat lehtësuese të parapara në Vendimin e BQK-së, për një periudhë të shkurtër kohore në fillimet e funksionimit të tij. Për këtë qëllim, funksioni për përmbyllje i BQK-së rekomandon masat në kërkesën që i paraqitet funksionit mbikëqyrës të BQK-së, në mënyrë që të merret vendimi për licencimin si dhe periudhën për të cilën institucioni urë duhet të jetë në pajtueshmëri me kërkesat e Ligjit për Bankat.
3. Licenca e institucionit urë lëshohet me shkrim dhe nuk është e transferueshme. Në licencë, pas emrit të bankës duhet të shënohet termi Institucion (bankë) urë.

Neni 5

Tranferimi i aseteve dhe detyrimeve

1. BQK zbaton procedurën e transferimit të aseteve, të drejtave dhe të detyrimeve të institucionit urë, sipas vendimit për përmbyllje.
2. Vlera e përgjithshme e detyrimeve të transferuara në institucionin urë nuk duhet të tejkaloj vlerën totale të të drejtave dhe aseteve të transferuara nga banka në proces të përmbylljes apo të të drejtave të siguruara nga burime të tjera.
3. BQK mund të transferoj më shumë se një herë aksionet, instrumentet tjera të pronësisë, asetet dhe detyrimet nga banka në proces të përmbylljes drejt institucionit urë.
4. BQK mund të transferoj prapa aksionet, instrumentet tjera të pronësisë, asetet, të drejtat dhe detyrimet nga institucioni urë te banka në proces të përmbylljes apo te pronarët fillestarë kur:
 - 4.1. mundësia e rikthimit të transferimit është përcaktuar shprehimisht në instrumentin me të cilin është bërë transferimi; apo
 - 4.2. aksionet specifike ose instrumentet e tjera të pronësisë, asetet, të drejtat ose detyrimet në fakt nuk bëjnë pjesë në kategoritë ose nuk i përmbushin kushtet për transferimin e aksioneve ose instrumenteve të tjera të pronësisë, aseteve, të drejtave ose detyrimeve të përcaktuara në instrumentin me të cilin është bërë transferimi.
5. Me aplikimin e instrumentit të institucionit urë, BQK mund të transferoj aksione, instrumente të tjera të pronësisë, asete, të drejta ose detyrime nga institucioni urë te një palë e tretë, sipas kushteve të paragrafit 4 të këtij neni.
6. Çdo rikthim i transferimit do të bëhet brenda periudhës dhe sipas kushteve të përcaktuara në instrumentin me të cilin është bërë transferimi fillestar.
7. Transferimet ndërmjet bankës në proces të përmbylljes, ose pronarëve fillestarë të aksioneve apo instrumenteve të tjera të pronësisë, nga njëra anë, dhe institucionit urë, nga ana tjetër, do t'i nënshtrohen masave mbrojtëse të përcaktuara në nenin 117 të Ligjit për Bankat.

8. Kur instrumenti i institucionit urë aplikohet për të transferuar disa, por jo të gjitha asetet, të drejtat ose detyrimet e një institucioni në përmbyllje të një pranues, ky transferim është subjekt i masave mbrojtëse të përcaktuara në nenin 117 të Ligjit për Bankat dhe rregulloren përkatëse të BQK-së.

Neni 6

Statusi i institucionit urë

1. Për qëllime të ushtrimit të të drejtave për ofrimin e shërbimeve sipas nenit 11 të Ligjit për Bankat, institucioni urë konsiderohet pasardhës ligjor i bankës në proces të përmbylljes dhe mund të vazhdojë të ushtrojë çdo të drejtë të tillë lidhur me asetet, të drejtat dhe detyrimet e transferuara, pavarësisht nga pëlqimi i kundërpalës.
2. Për qëllime të tjera, BQK mund të vendosë që institucioni urë të konsiderohet si vazhdimësi e institucionit në përmbyllje dhe të jetë në gjendje të vazhdojë ushtrimin e çdo të drejte që është ushtruar nga institucioni në përmbyllje në lidhje me asetet, të drejtat ose detyrimet e transferuara.
3. Institucioni urë mund të vazhdojë të ushtrojë të drejtat e anëtarësisë dhe të ketë qasje në sistemet e pagesave dhe kliringut, bursë dhe fondin e sigurimit të depozitave të bankës në proces të përmbylljes, me kusht që të përmbushë kriteret e anëtarësimit për pjesëmarrje në këto sisteme. Për qëllime të tilla:
 - 3.1. qasja nuk mohohet me arsyetimin se institucioni urë nuk posedon vlerësim nga një agjenci e vlerësimit kreditor, ose që ai vlerësim nuk është në proporcion me nivelet e vlerësimit, të kërkuara për t'u dhënë atyre qasje në ato sisteme;
 - 3.2. kur institucioni urë nuk i përmbushë kriteret e përcaktuara në këtë paragraf, autoritetet kompetente për dhënien e qasjes në sisteme të tilla mund, në kuadër të kompetencave të tyre, të lejojnë ushtrimin e këtyre të drejtave për një periudhë të caktuar kohe, jo më shumë se 24 muaj nga marrja e vendimit për themelimin e institucionit urë, ndërsa ky afat kohor mund të zgjatet, me kërkesë të institucionit urë, edhe për 12 muaj të tjerë.
4. Aksionarët ose kreditorët e bankës në proces të përmbylljes, si dhe palët e tjera të treta, asetet, të drejtat ose detyrimet e të cilëve nuk janë transferuar te institucioni urë, nuk kanë asnjë të drejtë mbi ose në lidhje me asetet, të drejtat ose detyrimet e transferuara te institucioni urë, po pjesëmarrjes në menaxhimin e institucionit urë, përveç të drejtave në masat mbrojtëse të përcaktuara në nenin 117 të Ligjit për Bankat.

Neni 7

Strategjia dhe profili i rrezikut të institucionit urë

1. Institucioni urë duhet të hartojë strategjinë e menaxhimit të rrezikut ndaj të cilit ekspozohet gjatë kryerjes së veprimtarisë së saj.
2. Strategjia dhe profili i rrezikut duhet të përmbajnë një përshkrim të rreziqeve më të rëndësishme ndaj të cilave ekspozohet institucioni urë dhe duhet të përmbajë së paku elementet e mëposhtme:
 - 2.1. procedurat për menaxhimin e rrezikut;
 - 2.2. parashikimet për menaxhimin e rrezikut të likuiditetit;
 - 2.3. parashikimet për ushtrimin e funksioneve të kontrollit të brendshëm;

- 2.4. parashikimet për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit;
- 2.5. parashikimet për nënshkrimin e marrëveshjeve me palët e treta për ushtrimin e funksioneve dhe të përgjegjësisë për menaxhimin e institucionit urë.

Neni 8

Organet qeverisëse të institucionit urë

1. Organet drejtuese të institucionit urë duhet të jenë sikurse përcaktohet me nenin 36 të Ligjit për Bankat.
2. Pavarësisht paragrafit 1 të këtij neni, BQK me qëllim të arritjes së objektivave të përmbylljes nga neni 100 dhe kushteve të përmbylljes nga neni 106 i Ligjit për Bankat, mund të vendosë që institucioni urë të ketë struktura më të thjeshta drejtuese. Në secilin rast, struktura drejtuese duhet të reflektohet në Statutin e institucionit urë.
3. Drejtoret dhe Menaxheret e lartë të propozuar të institucionit urë, duhet ti plotësojnë kriteret për drejtor dhe menaxher të lartë të përcaktuara me nenin 55 të Ligjit për Bankat dhe rregullativen përkatëse të BQK-së.
4. BQK mund t'i shkarkojë Drejtorët dhe Menaxheret e lartë të institucionit urë në çdo kohë.

Neni 9

Funksionimi i institucionit urë

1. Funksionimi i një institucioni urë respekton kërkesat e mëposhtme:
 - 1.1. përmbajtja e dokumenteve themeluese të institucionit urë miratohet nga BQK;
 - 1.2. në varësi të strukturës së pronësisë të institucionit urë, BQK emëron ose miraton organin drejtues të institucionit urë;
 - 1.3. BQK miraton kompensimin e anëtarëve të organit drejtues dhe përcakton përgjegjësitë e tyre të përshtatshme;
 - 1.4. Strategjia dhe profili i rrezikut të institucionit urë nga neni 7 i kësaj rregullore, miratohet nga BQK;
 - 1.5. institucioni urë licencohet në përputhje me Ligjin për Bankat dhe ka autorizimin (licencimin) e nevojshëm për të kryer aktivitetet ose shërbimet që i zotëron me anë të transferimit;
 - 1.6. institucioni urë është në përputhje me kërkesat, dhe i nënshtrohet mbikëqyrjes së BQK-së, sipas Ligjit për Bankat;
 - 1.7. funksionimi i institucionit urë mund të jetë subjekt i kufizimeve të operacioneve të tij sipas përcaktimeve nga BQK.
2. Menaxhimi i bankës urë synon ruajtjen e madhësisë dhe jo shtrirjen dhe zgjerimin e rrjetit të saj. Përmes këtij menaxhimi synohet ruajtja dhe rritja e vlerës së aseteve të bankës.

Neni 10

Raportimi dhe Mbikëqyrja e institucionit urë

1. Institucioni urë raporton çdo 3 muaj në BQK, në lidhje me ecurinë e gjendjes financiare si dhe të masave dhe projekteve për shitjen e tij. Përmes këtij raportimi, BQK në mënyrë të vazhdueshme

monitoron menaxhimin dhe gjendjen financiare të institucionit urë si dhe mbikëqyrë institucionin urë me synim tregtimin e tij dhe përgatitjen për shitje tek një ose më shumë blerës të sektorit privat, kur kushtet janë të përshtatshme dhe sa më shpejtë që të jetë e mundur.

2. Institucioni urë raporton në BQK sipas sistemit raportues të përcaktuar nga BQK.
3. Me kërkesë të BQK-së, banka urë mund të raportojë në periudha më të shkurta se sa përcaktohet në paragrafin 1 të këtij neni.
4. Institucioni urë respekton kërkesat ligjore dhe nënligjore në fuqi, në lidhje me ushtrimin e veprimtarive bankare dhe financiare të përcaktuara në vendimin e krijimit të tij.
5. Pavarësisht nga paragrafi 1 i këtij neni, BQK si autoritet mbikëqyrës e mbikëqyrë institucionin urë, në pajtim me kërkesat e Ligjit për Bankat dhe rregullativen përkatëse të BQK-së.
6. BQK mund të ndërmarrë ndaj institucionit urë masat mbikëqyrëse që i vlerëson të nevojshme, në përputhje me dispozitat e Ligjit për Bankat.

Neni 11

Shitja e institucionit urë

1. BQK do të realizojë shitjen e institucionit urë ose të aseteve, të drejtave apo detyrimeve të tij në kushte tregu, duke ndjekur parimin e transparencës dhe duke paraqitur, në masën më të madhe të mundshme, në mënyrë të saktë asetet, të drejtat dhe detyrimet si dhe duke ndjekur parimin e barazisë ndërmjet blerësve potencialë.
2. Shuma e përfituar nga shitja e institucionit urë, e zvogëluar me kundërvlerën e përcaktuar sipas paragrafit 13 të nenit 3 të kësaj rregulloreje, do t'u paguhet:
 - 2.1. aksionarëve të bankës në proces të përmbylljes, kur institucioni urë është themeluar përmes transferimit të aksioneve të tyre ose instrumenteve të tjera të pronësisë;
 - 2.2. bankës në proces të përmbylljes, kur institucioni urë është themeluar përmes transferimit, tërësisht ose pjesërisht, të aseteve, të drejtave ose detyrimeve të bankës në proces të përmbylljes.

Neni 12

Përfundimi i veprimtarisë të institucionit urë

1. BQK-ja merr vendim për përfundimin e veprimtarisë të institucionit urë në rastet e mëposhtme:
 - 1.1. institucioni urë bashkohet me një bankë tjetër;
 - 1.2. institucioni urë nuk plotëson më tutje kërkesat e përcaktuara në nenin 109 të Ligjit për Bankat dhe të kësaj rregullore;
 - 1.3. janë shitur të gjitha ose shumica e aseteve, të drejtave ose detyrimet të institucionit urë;
 - 1.4. përfundon afati i përcaktuar sipas paragrafi 2 i këtij neni dhe kur aplikohet afati nga paragrafi 3 të këtij neni.
 - 1.5. kur asetet e institucionit urë likuidohen të gjitha dhe detyrimet e tij shlyhen plotësisht.

2. Nëse asnjë nga rrethanat e përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni nuk ka ndodhur, BQK merr vendim për përfundimin e institucionit urë sa më shpejtë të jetë e mundur dhe, në çdo rast, më së largu dy vjet pas datës në të cilën është bërë transferimi i fundit nga një bankë në proces të përmbylljes në përputhje me instrumentin e institucionit urë.
3. BQK-ja mund të zgjasë afatin e përcaktuar në paragrafi 2 të këtij neni për 1 (një) ose më shumë periudha 1 (një) vjeçare nëse një zgjatje e tillë:
 - 3.1. mbështet arritjen e rezultateve të përmendura në paragrafin 1 të këtij neni; ose
 - 3.2. është e nevojshme për të siguruar vazhdimësinë e shërbimeve thelbësore bankare ose financiare.
4. Vendimi i përmendur në paragrafin 3 të këtij neni duhet të jetë plotësisht i arsyetuar dhe të përmbajë një vlerësim të detajuar të situatës, përfshirë kushtet e tregut dhe arsyet për shtyrjen e afatit.
5. Kur operacionet e një institucioni urë përfundojnë sipas rrethanave të përmendura në nënparagrafët 1.3 ose 1.4, të paragrafit 1 të këtij neni, institucioni urë mbyllet sipas procedurave të rregullta të likuidimit.
6. Në varësi të nenit 3 paragrafi 13 të kësaj rregulloreje, të hyrat e gjeneruara si rezultat i përfundimit të funksionimit të institucionit urë iu takojnë aksionarëve të institucionit urë.
7. Kur një institucion urë përdoret për qëllimin e transferimit të aseteve dhe detyrimeve të më shumë se një banke në proces të përmbylljes, detyrimi i përmendur në paragrafin 6 të këtij neni, i referohet aseteve dhe detyrimeve të transferuara nga secila prej bankave në proces të përmbylljes dhe jo vetë institucionit urë.

Neni 13

Revokimi i licencës së institucionit urë

1. Pas përfundimit të aktivitetit të institucionit urë sipas nenit 12 të kësaj rregullore, BQK i revokon licencën.
2. Pas revokimit të licencës, asetet dhe detyrimet e pa transferuara i nënshtrohen procedurave normale të likuidimit të përcaktuara me Ligjin për Bankat.

Neni 14

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas miratimit nga Bordi i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës.

Dr. Sc. Bashkim Nurboja

Kryetar i Bordit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës